



Prishtinë, 05 qershor 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1159\_2019

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

##### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrithshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin të ndërtuar në parcelën ngastradastrave Nr. 1601-1, ZK Izvor, me kapacitet të instaluar prej **5 kW** në Komunën e Novobërdës, të datës 16.05.2019 me nr. prot. 301/2019 të aplikuesit Besiana G SH.P.K., me adresë: fshati "Izvor", Komuna e Novobërdës, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 05 qershor 2019 nxori këtë:

### V E N D I M

#### PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET-** kërkesa e aplikuesit Besiana G SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastradastrave Nr. 1601-1, ZK Izvor, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Novobërdës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi Besiana G SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR-90049616 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrojë kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi Besiana G SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.


### A r s y e t i m



- ZRRE, me datë 16.05.2019 nga aplikuesi Besiana G SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, mbi objektin e ndërtuar në parcelën ngastra Nr. 1601-1, ZK Izvor, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, që do të vendosen mbi objekt, shifra e konsumatorit DPR-90049616, Komuna e Novobërdës.
  - Aplikuesi, s’bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 1784 të datës 20.03.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., projektin ekzekutues dhe Pëlqimin Nr. 09-248 të datës 10.05.2019 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikimin, Urbanizmin, Kadastrin & Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Novobërdës.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit Besiana G SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në kulmin e shtëpisë individuale të ndërtuar në parcelën ngastra kadastrave Nr. 1601-1, ZK Izvor, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i Rregullatorit:**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Selijaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Novobërdës,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.